

V E N D I M
Nr.394, datë 27.5.1996

**PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE PËR VLERËSIMIN E PASURIVE TË
PALUAJTSHME**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit e Turizmit dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pranë Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit të krijohet komisioni i posaçëm për dhënien e licencave për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.
 2. Çdo person fizik ose juridik shqiptar që dëshiron të ushtrojë profesionin privat të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, duhet të pajiset me licencë profesionale, në përputhje me rregulloren e posaçme të hartuar nga shoqota "Shoqëria e Vlerësimeve të Pasurive të Paluajtshme".
 3. Çdo licencë tjetër ose ushtrim profesioni i këtij karakteri në kundërshtim me këtë vendim është i pavlefshëm.
 4. Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera, sipas fushave përkatëse, të miratojë rregulloren e komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, Ministria e Financave dhe shoqata "Shoqëri e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme".
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi